Rev.nr.299/2019

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A. K., Komuna e Klinës, të cilin me autorizim e përfaqëson Xh M, av. nga Klina, kundër të paditurit B N, nga, Komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqëson Sh N, lidhur me çështjen juridike për kompensimin e dëmit, përkitazi me revizionin e paditurit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1295/2017 datë 27.5.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15.10.2019, merr këtë:

A K T GJ Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurit B.N, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1295/2017 datë 27.5.2019.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1295/2017 datë 27.5.2019, është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e të paditurit B. N., dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Pejë-Dega në Klinë, C.nr.21/2001 datë 12.12.2016, ashtu që është detyruar i padituri B. N., që paditësit A. K., nga ..., në emër të dëmit jo material, për dhimbje fizike trupore t'ia kompensojë shumën prej 4.000 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 3.000 € dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 25% shumën prej 7.500 €, me kamatë si për mjetet e deponuara në bankat afariste, pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimi e deri në pagesën definitive dhe pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar për këto kategori të dëmit, është refuzuar si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar në pjesën tjetër të dispozitivit, është vërtetuar. Me pjesën II të dispozitivit ka mbetur e pashqyrtuar pjesa refuzuese e kërkesëpadisë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i padituri ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që

aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar, të ndryshohen shumat e gjykuara për kompensim, apo që të dy aktgjykimet të prishën dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se më datë 23.6.2000, në rrugën Pejë – Prishtinë, në fshatin Poterq, i padituri duke drejtuar automjetin e markës ''Opel Omega'', për shkak të shpejtësisë së tejkaluar nga ajo e paraparë për vendin e caktuar, nuk ka arritur të ndalet në shenjën STOP të policit –këtu paditësit, A.K., pjesëtar i SHPK-ës, dhe me pjesën anësore të mbrojtësit të automjetit e godet paditësin, me ç'rast i njëjti pëson thyerje të hapur të kërcirit të djathtë të shkallës së tretë, i cili lëndim është i natyrës së rëndë trupore, që si pasojë paditësi ka pas dhimbje trupore, ka pësuar frikë dhe zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 25%. Me aktgjykimin penal P.nr. 27/2000 datë 3.11.2000, i padituri është shpallë fajtor dhe është dënuar sipas ligjit, ndërsa i padituri nuk ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ashtu që ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar në pjesën e cila ka të bëjë me dhimbjet fizike trupore, frikën, zvogëlimin e aktivitetit jetësor dhe kamatën, ndërsa në pjesën tjetër të aktgjykimit, ankesën e ka refuzuar si të pabazuar.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, drejt i kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtës materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vendosur kur të paditurin ka obliguar që paditësit t'ia paguajë shumat e cekura si në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar, për dhimbjet fizike shumën prej 4.000 €, për frikë shumën prej 3.000 € dhe për zvogëlimin e aktivitetit jetësore shumën prej 7.500 € . Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, shumat e gjykuara në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material lidhur me shkallën e intensitetit, kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësore. Vërtetimi i shpërblimit për dëmin jomaterial përfaqëson zbatim të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykatat sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdesen për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimin të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për faktin që synimet e tilla të jenë të pajtueshme me natyrën dhe qëllimin shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë ligjore, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësit, shkallën e intensitetit, kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aftësisë jetësore, sipas gjendjes së vërtetuar me anë të ekspertizës së ekspertit Dr. Isa K. – ortopedë dhe Dr. M. H. - psikiatër, e duke pasur parasysh edhe standardin jetësor të

qytetarëve të Kosovës, por edhe praktikën e deritanishme të gjykatave të Kosovës, shumat e cekura të shpërblimit të dëmit jo material të paditësit, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë adekuate dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas dispozitës së cekur.

Pretendimi i revizionit se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182.2 pika (n) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është i pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe përmban arsye të mjaftueshme për gjykim të drejtë e të ligjshëm. Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret se ku qëndron kundërthënia në mes procesverbaleve të shqyrtimit kryesor dhe përmbajtja e dokumenteve, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar, ngase për Gjykatën Supreme nuk është e mjaftueshme vetëm citimi i dispozitës ligjore, por pretendimi i revizionit duhet me qenë konkret dhe i qartë.

Pretendimin se gjykata e shkallës së dytë në aktgjykimin e sajë nuk ka dhënë përgjigje në pretendimin e ankesës se si është konsideruar padia e paditësit e tërhequr dhe si ka ardhur deri të vazhdimi i procedurës, Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Klinë, më datë 20.7.2015, paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore, me vërejtjen se nëse brenda 7 ditëve nuk e paguan taksën, padia do të konsiderohet e tërhequr, mirëpo paditësi më datë 6.6.2016 ka bërë pagesën dhe shqyrtimi kryesor ka vazhduar, ndërsa gjykata nuk ka marrë aktvendim për të konstatuar se padia e paditësit është tërhequr, andaj një pretendim i tillë i të padituri është i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë analizuar me kujdes mendimet e ekspertëve lidhur me zvogëlimin e aktivitetit jetësor se a është zvogëlimi i natyrës së përkohshme apo të përhershme dhe lidhur me frikën, por kjo nuk ndikojë për të vendosur ndryshe nga gjykatat e instancës më të ulët, sepse eksperti nga lëmia e psikiatrisë ka dhënë sqarime në shqyrtimin kryesor dhe i autorizuari i të padituri nuk ka parashtruar pyetje për ekspertin dhe nuk ka dhënë vërejtje në mendimin e tij, ndërsa nuk ka qen prezent me rastin kur është dëgjuar eksperti Dr. I. K. – ortopedë dhe nuk ka kërkuar caktimin e ndonjë ekspertize tjetër.

Në revizion i padituri thekson se mbetet në tërësi pran pretendimeve të paraqitura në padi, parashtresa dhe pretendimet e paraqitura në ankesë, por kjo Gjykatë konstaton se të njëjtat kanë qenë objekt shqyrtimi para gjykatave të instancës më të ulët dhe Gjykata Supreme aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton vetëm sipas pretendimeve të paraqitura në revizion.

Në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK –ës revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, nuk shqyrtoi pretendimet e revizionit në këtë drejtim.

Në revizion nuk është cekur asnjë dispozitë ligjore e ligjit material të cilën gjykatat e instancës më të ulët e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar, apo nuk e kanë zbatuar fare dhe në këtë drejtim i padituri nuk ka paraqitur asnjë pretendim konkret, ndërsa kjo Gjykatë duke shqyrtuar

zbatimin e të drejtës materiale sipas detyrës zyrtare, vlerëson se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 154,155, 185 dhe 200 të LMD-ës, të cilat kanë qenë në fuqi në momentin e shkaktimit të aksidentit.

Gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka vendosur që i padituri pjesën e gjykuar të kërkesëpadisë paditësit t'ia paguaj me kamatë si për mjetet e deponuara në bankat afariste pa destinim të caktuar për një vit, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë më 12.12.2016, e deri në pagesën definitive.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
Rev.nr.299/2019 datë 15.10.2019

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku